

AKT THEMELIMI DHE STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“KALAJA TALENT CONSULTING”

Sot me date 11/04/2024 (Njëmbëdhjetë prill dymijë e njëzet e katër), u mbledhën themeluesit në adresën **Rruga Myslym Shyri; Nd. 56, H.1; Njesia administrative Nr.7, Njesia bashkiake Nr.7, 1001, Tiranë Shqipëri** të cilët bazuar në legjislacionin në fuqi, në nenet 68 e vijues të ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 “Për Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014, Ligjit nr. 9723, dt.03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Ligj Nr. 131/2015 Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” në dispozitat e Kodit Civil si dhe në vullnetin e tyre të lirë kanë rënë dakord për themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar **sipas rregullimeve në vijim:**

KREU I.

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJE, SELIA

NENI 1

Emri

Emri i shoqërisë është “KALAJA TALENT CONSULTING” Sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 2

Ortakët themelues

Themeluesit e shoqërisë janë:

1. Z. Klejti Kalaja, shtetas Shqipëtar, atësia Arben, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 18/12/1992, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me ID nr.J21218039S.

i cili themelon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “KALAJA TALENT CONSULTING” Sh.p.k. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin në fuqi në territorin e Shqipërisë dhe dispozitat e Aktit të Themelimit dhe këtij Statuti.

NENI 3

Objekti i Shoqërisë

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

- Zhvillim dhe shërbime të burimeve njerezore.
- Konsulencë në burime njerezore;
- Ndermjetësim në tregun e punës.
- Organizim i trajnimeve dhe konsulencë për menaxhimin e shitjeve.
- Konsulencë marketing.
- Studime & Analize tregu
- Shërbime dhe komisione ndermjetësimi, organizim eventesh
- Organizim i trajnimeve specifike sipas kërkesave të bizneseve
- Shërbim dhe konsulencë për hyrje në treg
- Komisione ndermjetësimi
- Konsulencë të burimeve njerezore
- Ndermjetësim tregtar ndermjet bizneseve
- Dhënie ambjentesh me nënqera.
- Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si edhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si edhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelimin e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë, që është në përputhje dhe nuk ka kufizime në legjislacionin Shqiptar.

Shoqëria, me vendim të organit administrativ, dhe me qëllim arritjen e objektit të saj, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo ndërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprim tregtar që organi administrativ do ta konsiderojë të nevojshëm. Për këtë qëllim, Shoqëria mund të lidhë marrëveshje apo kontrata qiraje, shit-blerje a hipotekimi të pasurive të paluajtshme, kontrata kredie, shërbimi dhe marrëveshje a kontrata të tjera të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit.

NENI 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohë të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar.

NENI 5

Selia e Shoqërisë

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Myslym Shyri; Nd. 56, H.1; Njesia administrative Nr.7, Njesia bashkiake Nr.7, 1001, Tiranë Shqipëri. Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose të krijojë filiale, si dhe të kryejë aktivitetin e saj si brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

KREU II

KAPITALI

NENI 6

Kapitali i Regjistruar

Kapitali themeltar është 10,000 (Dhjetë Mijë) Lek dhe është i ndarë në 1 kuotë 10,000 (Dhjetë Mijë) Lek. Kapitali themeltar është nënshkruar dhe derdhur tërësisht nga Ortaku i Shoqërisë si mëposhtë:

1. Z. Klejti Kalaja, shtetas Shqipëtar, atësia Arben, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 18/12/1992, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me ID nr.J21218039S zotëron 1 kuotë që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë, me vlerën nominale 10,000 lekë, e shlyer tërësisht.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/ të paluajtshme, apo të drejta)

Neni 7

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit të regjistruar për kontribute në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkohet për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi prek në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 8

Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen si mëposhtë :

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) Shitblerjes
- c) Trashëgimisë
- d) Dhurimit
- e) Cdo mënyre tjetër e parashikuar me ligj

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organet Vendimmarrëse

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme është kompetente për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet si më poshtë:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- b) Ndryshimin e statutit
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorit/administratorëve
- d) Emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën c) e d)

- f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori/administratorët përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- g) Miratimin e bilanceve
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j) Përfaqësimin në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit/administratorëve
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- l) Miraton rregulla proceduriale të mbledhjeve të asamblesë
- m) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 10

Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është e thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 11

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë personalisht

apo votojnë me shkresë apo elektronikisht ortakët, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Në rastin kur asamleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumica të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse kuorumi i përmendur në paragrafin e mësipërm nuk arrihet, asamleja e përgjithshme, mbidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Marrja e Vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të zotëruesve të kapitalit të ortakëve pjesmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesmarrës, për çështje të tjera.

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në regjistrin e shoqërisë.

Neni 13

Përijashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asamleja e përgjithshme merr vendimin për:

- a) Vlerësimin e veprimtarisë së tij
- b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij
- c) Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria
- d) Dhënien ose jo të përfitimeve të reja

Kur ortaku perfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 14

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorit/administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.

Administratori i parë i Shoqërisë është Z. Klejti Kalaja, shtetas Shqipëtar, atësia Arben, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 18/12/1992, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me ID nr.J21218039S.

Administratori mund të shkarkohet në çdo moment me vendim të Ortakëve.

Gjithashtu, Administratori mund të shkarkohet në çdo moment me vendim të Autoritetit Gjyqësor kompetent për shkelje të ligjit.

Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Administratori i vetëm i cili kryen të gjitha veprimet në lidhje me aktivitetin e zakonshëm apo të jashtëzakonshëm të Shoqërisë.

Neni 15

Kompetencat e Administratorit/Administratorëve

Administratori/ Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për realizimin e objektit të shoqërisë me përjashtim të kompetencave që ligji apo statuti ia jep shprehimisht Ortakut të Vetëm
- b) Përfaqësojnë shoqërinë
- c) Kujdesen për mbajtjen e sakte dhe të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël të shoqërisë
- d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurisë së veprimtarisë si dhe raporte të tjera sipas kërkesave ligjore dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimit, i paraqesin këto dokumenta përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim
- e) Krijojnë një sistem paralajmerimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.

- f) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhëna të detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombetare të Regjistrimit.
- g) Raportojnë para Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet relacioneve mbi zbatimin e politikave të shoqërisë dhe të veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë
- h) Kryejnë detyra të parashikuara nga ligji dhe statuti

Administratori është individualisht përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe të tretëve për shkelje të ligjit dhe/ose Statutit.

Neni 16

Përgjegjësitë e Administratorit/Administratorëve

1. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Administratorët të cilët kanë kryer veprime ose bërë marrëveshje të pa aprovuara nga asambleja, janë përgjegjës për dëmet e sjella shoqërisë dhe përgjigjen personalisht ose solidarisht për pasojat.
2. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale është i detyruar të dëmshpërmbledjë shoqërinë për dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe të kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

KREU IV

VITI FINANCIAR- EKSPERTET

Neni 17

Viti Financiar

Viti financiar fillon me datë 1 Janar dhe mbyllet me datë 31 Dhjetor të çdo viti. Përrjashtimisht, viti i parë financiar do të fillojë nga dita e regjistrimit pranë Regjistrimit Tregtar dhe do të përfundojë më 31 Dhjetor 2024.

Neni 18

Ekspertët Kontabël

Asambleja e Ortakëve do të emëroje një apo më shumë Ekspertë Kontabël në ato raste kur emërimi behet i nevojshëm në bazë të ligjit.

KREU V

PRISHJA- RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni 19

Prishja/ Likuidimi

Shoqëria konsiderohet e shpërndarë kur:

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar e shoqërisë
- b) Me vendim të asamblesë së ortakëve
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit
- d) Me vendim gjykate

Në rast prishje a likuidimi të shoqërisë, normat për likuidimin dhe emërimin e likuiduesve do të vendosen nga Ortakët e shoqërisë në bazë të ligjit në fuqi në territorin e Shqipërisë.

Neni 20

Riorganizimi i Shoqërisë

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit mbi shoqëritë tregtare.

Neni 21

Klauzola mbi konfliktin e interesit

Ortakët dhe administratori/administratorët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, nuk mund të mbajnë pozicionin drejtues apo të jenë të punësuar në një shoqëri që ushtron aktivitet në të njëjtën fushë me të parën.

Ndalimi i pikës I mund të anulohet në Asamblenë e parë të përgjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave, sipas dispozitave të neneve 87 dhe 145 të ligjit për shoqëritë tregtare.

Neni 22

Legjislacioni

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

KREU VI

TE TJERA

Neni 23

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, si dhe ato që mund të lindin midis ortakëve ose midis një apo disa ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe të drejtëpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ajo do t'i besohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 24

Gjuha

Ky statut është hartuar në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU THEMELUES

KLEJTI KALAJA

Klejt Kalaja

